

Newsletter

Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Maj - Gusht ka marrë 24 vendime:

- **Marrëveshje të ndaluara:** 3 vendime;
- **Abuzim me pozitën dominuese:** 3 vendime;
- **Përqendrime:** 11 vendime;
- **Rekomandime:** 3 vendime;
- **Përfshirje nga marrëveshja:** 2 vendime;
- **Vendime të tjera:** 2 vendime.



Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

1 Abuzim me pozitën dominuese

Tregu i ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse

Komisioni i Konkurrencës me Vendim nr. 884, datë 18.05.2022, vendosi:

- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN-së;
- Detyrimin e ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje me të drejta të veçanta nëpërmjet Kontatës së koncesionit "Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm", që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

2 Përqendrim

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 60, të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, ka autorizuar përqendrimin e përkohshëm me vendim nr. 901, datë 29.07.2022 "Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Vishnupriya Farms Private Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings As". Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.

3 Përjashtim nga marrëveshja

Komisioni i Konkurrencës, me Vendim nr. 905, datë 29.07.2022, vendosi të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe. Marrëveshja nuk ndikon në pjesëmarrjen në treg të Sanof në lidhje me Produktet e Përjashtimit, pasi tregu i produkteve Swixx me receta në Shqipëri nuk mbivendoset me klasat ATC3 të produkteve të Sanof. Pas implementimit të Marrëveshjes, kushtet konkurruese të tregut do të mbeten të njëjta.

4 Udhëzim

Komisioni i Konkurrencës, me Vendim nr. 890, datë 10.06.2022 vendosi për miratimin e Udhëzimit "Mbi kufizimet e konkurrencës "sipas objektit" për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël".



Aktivitete



Në kuadër të promovimit të mëtejshëm të kulturës së konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës vijon me takimet e organizuara si një traditë e re komunikimi me grupet e interesit, botën akademike me qëllim njohjen dhe promovimin e kulturës së konkurrencës dhe forcimin e bashkëpunimit me biznesin.

- Në datën 07.06.2022, në qytetin e Fierit, u zhvillua workshop-i me temë "Për rritjen e kulturës së konkurrencës dhe forcimin e bashkëpunimit me biznesin" me pjesëmarrjen e Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba, përfaqësues të AK dhe përfaqësues të biznesit të Rrethit Fier.
- Në datën 31.05.2022, në ambientet e Universitetit European të Tiranës, u zhvillua workshop-i me temë "Promovimi i mëtejshëm i kulturës së konkurrencës me botën akademike" me pjesëmarrjen e Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba, përfaqësues të AK, profesorë dhe studentë të programit master në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë.
- Në datën 19.05.2022, në ambientet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, u zhvillua leksioni i hapur me temë "Zbatimi i Ligjit Nr. 9121 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", datë 28.07.2003 dhe rregullimi i tregut" me pjesëmarrjen e Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba, përfaqësues të AK, profesorë dhe studentë të programit master në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë.

Këto takime informative/edukuese do të vijojnë të organizohen nga Autoriteti i Konkurrencës jo vetëm në kuadër të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021", por edhe si mision që Autoriteti i ka vendosur vetes për promovimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës.